



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Lënda : Relacion mbi Raportin e Monitorimit për periudhën Janar –Dhjetor 2020.

Në zbatim të ligjit Nr 88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 20.01.2020 “ Për zbatimin e buxhetit 2020”, dhe udhëzimit Nr.22 datë 17.11.2016, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të qeverisjes qendrore”, Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka përgatitur formatet e Raportit të Monitorimit, për katërmujorin e tretë të vitit 2020.

Theksojmë lidhur me përgatitjen e formateve të raportit të monitorimit, Institucioni është kategorizuar te programi 01150 “Shërbime të tjera”, grupi 87. Produkti i realizuar nga institucioni jonë është “Dosje të kaluara për shqyrtim në kkt”.

Artikujt	Output code	Buxheti në 000/ Lekë për vitin 2020 i ndryshuar	Realizimi deri në dt 30.04.2020	Realizimi në %deri në dt 30.04.2020	Diferenca
Paga 600	98704AE	40,200	39,696	99 %	504
Sig-shoq,shënd 601	98704AE	6,700	6,558	98 %	142
Korrente të Tjera (602-606)	98704AE	33,087	32,986	99.7 %	101
Investime 231	18AO201	1,000	842	84%	158
Total shpenzime korrente +Investime		80 ,987	80,082	99 %	905

Sic shihet nga tabela më sipër, shpenzimet për paga , sigurime shoqërore shëndetësore , shpenzime korrente të tjera për katërmujorin e tretë të vitit 2020 janë realizuar përkatësisht 99 % , 98 % ,

99.7 % . Shpenzimet për investimet kapitale janë realizuar 84% për vitin 2020. Janë respektuar limitet mujore sipas planit mujor të paraqitur në thesar.

Te zëri shpenzime për blerje mallra dhe shërbime, shpenzimet që institucioni ekzekuton çdo muaj janë shpenzimet për qeranë e zyrave të Azht-së, shpenzimet për pagesën e qerasë për mbledhjet e KKT-së, shpenzimet për marrjen e një automjeti me qera, shpenzime për shërbim ruajtje dhe sigurimi, shpenzimet për energji elektrike, ujë, postë dhe telefon. Këtu përfshihen edhe shpenzime të tjera si blerje kancelari, materiale pastrimi, shërbime printim- publikim, dizifektim i ambienteve, mirëmbajtje për të cilat institucioni ka nevojë gjatë vitit si dhe taksa dhe detyrime vjetore.

Organika e institucionit është plotësuar me 43 punonjës. Theksojmë se nga muaji mars 2020 e deri në fund të vitit 2020 institucioni jonë ka mbuluar shpenzimet për paga dhe sigurime për 5 punonjës me kontratë përkohshme të Ministrisë së Rindërtimit në kategorinë specialist, referuar shkresave të Kryeministrisë nr.1450 prot dt 02.03.2020 dhe nr 1450/1 prot dt 03.03.2020. Për këtë arsye gjatë vitit i kemi kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë shtesë fondi te llogaria e pagave 600 dhe sigurimeve 601 pasi fondi i akorduar në fillim të vitit ka qënë i përcaktuar vetëm për 43 punonjësit e Azht-së.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Ledia Tota